



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenin 23 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i njohur, në vazhdimin e seancës së 50-të, të mbajtur më datë 22.007.2021 morri,

VENDIM

Denoncimi me numër 12-4665/ 1 të datës 07.10.2019 e dorëzuar nga parashtrues i njohur, **REFUZOHE**T.

Pohimet në denoncim nuk përmbajnë elemente për veprime kompetente të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

Lënda me numër 12 -4665 e vitit 2019 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Kopje nga vendimi të dorëzohet deri te parashtruesi i denoncimit.

Arsyetim

Lënda me numër 12-4665 e vitit 2019 e formuar në bazë të denoncimit me nr. 12-4665 / 1 të datës 07.10.2019 nga parashtrues i njohur----- nga ----- . Në denoncim tregohen dyshime për kufizime të konkurrencës pas shpalljes publike në vitin 2019 të publikuar nga -----, siç theksohet në denoncim "duke favorizuar vetëm një pjesëmarrës". Denoncimi është dorëzuar në periudhën kur shpallja publike ishte ende në proces, gjegjësisht në fazën e dorëzimit të ofertave.

Denoncuesi në denoncim kthehet në procedurën e prokurimit publik të vitit të kaluar, duke deklaruar se nga 4 (katër) persona juridikë të lajmëruar, ndër të cilët edhe ai si person juridik, në procedurën e vlerësimit të ofertave, tre ofertues që morën pjesë në procedurë u refuzuan për shkak të, vërejtje formale ", dhe vetëm ofertuesi ----- si ofertuesi i vetëm vazhdoi

procedurën e mëtejshme. Asnjë ankand elektronik nuk është kryer në procedurën e prokurimit publik për shkak të ofertuesit të vetëm.

Në denoncim, denoncuesi nuk ka përmendur indikacione konkrete për shkak të parregullsive të cilave atij iu refuzua pjesëmarrja e mëtejshme në procedurë.

Për më tepër, ai vazhdon duke thënë se në Shpalljen e Prokurimit Publik të vitit 2019, siç thotë ai, përkundër faktit se ka një numër të madh të importuesve të ushqimit të peshkut, u regjistruan vetëm dy pjesëmarrës, gjatë së cilës përsëri kushtet u përshtatën me një pjesëmarrës në procedurë.

Ndaj denoncimit, denoncuesi ka dorëzuar edhe Shpallje të Prokurimit Publik me numër ---- / ---- nga faqja e internetit e Byrosë së Prokurimit Publik si në Pjesën IX: Njoftimet për kontratën e lidhur / regjistrimet citohet se "Nuk ka njoftime për kontratën e lidhur", që mund të kolaudohet se në kohën e parashtrimit të denoncimit nga parashtruesi, ende nuk ka kontratë të lidhur për lëndën e prokurimit publik, me çka nuk mund të konfirmohen indikacionet e parashtruesit.

Për arsye të faktit se procedura ishte në vazhdim dhe operatori ekonomik mund ti përdorte mekanizmat ligjorë dorëzoi ankesë në KSHFAP, Komisioni Shtetëror vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent për arsye se i njëjti nuk i përdori mekanizmat e dhënë dhe kontrata ishte lidhur në ditën ----. 2019.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËRO
PËR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT
Kryetar,
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te:

Arkivi
Parashtruesi

Përgatiti: M.r K.Z, Këshilltar

Miratoi: K.N, anëtar i KSHPK - së

